



RAPORT MONITORIMI

Arsimi

Maj-Korrik 2020



AUTOR

Migen Qiraxhi

QENDRESA
QYTETARE



National Endowment
for Democracy
Supporting Freedom around the World

www.qeverisja.qq.com.al



Anti-plagjiatura në Kodin Penal

Sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, plagjiatura si vepër penale ka një masë nga gjobë deri **në dy vjet burgim**. Në nenin 148 të Kodit Penal thuhet: “Botimi ose përdorimi tërësisht apo pjesërisht me emrin e vet të një vepre letrare, muzikore, artistike ose shkencore që i përket një tjetri, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”.¹

Neni 148

Botimi i veprës së tjetrit me emrin e vet
(Ndryshuar me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001)

Botimi ose përdorimi tërësisht apo pjesërisht me emrin e vet të një vepre letrare, muzikore, artistike ose shkencore që i përket një tjetri, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Por edhe pse është kjo masë dënimi, për këtë vepër penale është shumë e vështirë që ata që kanë bërë plagjiaturë të dënohen.

Kodi i Procedurës Penale, i pa ndryshuar deri në vitin 2017, parashikonte se plagjiatura mund të hetohej menjëherë nga prokuroria, pa ankimin e një pale të dëmtuar.

Por në vitin 2017, Kodi i Procedurës Penale pësoi ndryshime rrënjësore dhe në nenin 284 të tij në pikën e parë parashikoi se vepra penale e nenit 148 të Kodit Penal (plagjiatura), nuk mund të niset/hetohet kryesisht nga prokuroria, por vetëm me ankimin e të dëmtuarit. Pra, që një pedagog të dënohet nga gjykata, duhet me patjetër që të ankohet personi i cili zotëron punimin shkencor origjinal prej të cilit është vjedhur.²

Neni 284

Ankimi

(Ndryshuar pika I me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002)

1. Për veprat penale të parashikuara nga nenet 89, 102 paragrafi i parë, 105, 106, 130, 239, 240, 241, 243, 264, 275 dhe 318 të Kodit Penal, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e të dëmtuarit, i cili mund ta tërheqë atë në çdo fazë të procedimit.
2. Ankimi bëhet nga i dëmtuari te prokurori ose në policinë gjyqësore me anën e një deklarate, në të cilën personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të posaçëm, shfaqet vullneti që të procedohet në lidhje me një fakt të parashikuar nga ligji si vepër penale.
3. Kur ankimi bëhet me gojë procesverbali që mbahet për këtë qëllim nënshkruhet nga ankuesi ose përfaqësuesi i tij.
4. Ai që merr ankimin sigurohet për identitetin e ankuesit dhe i dërgon aktet prokurorit.
5. Për rastet e parashikuara nga neni 59, ankimi bëhet në gjykatë nga i dëmtuari akuzues.

¹ http://www.pp.gov.al/web/kodi_penal_2017_1200.pdf

² http://www.pp.gov.al/web/kodi_i_procedures_penale_date_30_gusht_2017_1201.pdf



Të gjithë akademikët apo politikanët që kanë bërë plagjiaturë, nuk mund të dënohen nëse vetë personat të cilët janë dëmtuar të mos bëjnë kallëzime/ankime pranë organeve ligjzbatuese shqiptare. *Ky ndryshim i ndihmon plagjiatorët pasi deri tani nga denoncimet që janë bërë publike, punimet doktorale janë kopjuar nga shtetas të huaj apo shtetas të cilët kanë ndërruar jetë dhe është thujse e pamundur që këta shtetas të shprehin interes për t'u ankuar në organet ligjzbatuese shqiptare.*

Problemi kryesor i përhapjes së plagjiaturave në masë në vendin tonë është impaktimi i drejtpërdrejtë i cilësisë në sistemin arsimor pasi avancimet akademike të kryera nëpërmjet artikujve të kopjuar janë fiktive, dëmtojnë konkurrencën mes pedagogëve dhe krijojnë modele negative tek studentët. Në muajin tetor 2018 u dorëhoq një zvendësminsitër arsimit pas publikimit të plagjiaturës në punimet e tij. Akti i dorëheqjes nuk u shoqërua me nisjen e një hetimi nga prokuroria, por pëkundrazi u promovua nga forca e tij politike (Partia Socialiste) si kandidat dhe më pas fitues për postin e Kryetarit të Bashkisë së Beratit.³



Kontrolli Anti - Plagjiaturë i premtuar nga qeveria

Gjatë protestës studentore në dhjetor 2018, një nga 8 kërkesat e studentëve ishte edhe **“Rishikimi i titujve akademikë dhe verifikimi i plagjiaturave të doktoraturave dhe teksteve mësimore”**, kërkesë e cila lidhej drejtpërdrejt me cilësinë e mësimdhënies dhe nivelit të stafit akademik. Qeveria shqiptare e ndodhur nën presion e adresoi këtë çështje në Paktin për Universitetin, i cili u publikua në fillim të vitit 2019, si një dokument politikash për ndryshimin e sistemit arsimor.⁴




³ <https://shqiptarja.com/lajm/u-akuza-per-plagjiature-jep-doreheqjen-zv-ministri-i-arsimit-ervin-demo?r=dtr>

⁴ <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2019/01/DRAFT-PAKTI-PER-UNIVERSITETIN.pdf>

Në 26 Dhjetor 2018 u miratua VKM nr. 777 për kontrollin anti-plagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore e cila ngarkonte **Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me përgjegjësi për realizimin e kontrollit të disertacioneve dhe krijimin e arkivit digjital të disertacioneve të përdorura për fitimin e gradave shkencore.**⁵ Por pavarësisht këtij vendimi, kontrolli anti-plagjiaturë mbeti vetëm në letër për një periudhë 1 – vjeçare, gjithashtu i pambajtur është edhe premtimi i krijimit të arkivit digjital të disertacioneve, i cili do të ishte publik për qytetarët, studentët dhe pedagogët.

Pas presionit të vazhdueshëm nga studentët dhe organizatat e shoqërisë civile një vit më vonë, në dhjetor 2019 Ministria e Arsimit bleu soft-in “Platforma Akademia”, një sistem antiplagjiaturë që do i shërbente për të kontrolluar disertacionet sipas VKM 777 në vlerën 20 000 euro të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit.



Deshtimi i Ministrisë së Arsimit për të kryer qofte edhe një kontroll të vetëm anti-plagjiaturë, shënon precedentin jo vetëm të mos zbatimit të vendimit të këshillit të ministrave nga ana e Ministrisë së Arsimit por edhe të mos mbajtjes së premtimit që Kryeministri i vendit u bëri studentëve në Dhjetor të 2018.

E gjendur në presion te vazhdueshem per mos kryerjen e kesaj kerkese te studentëve, **më 14 janar 2020 Ministria e Arsimit, nëpërmjet Urdhërit nr.8 urdhëroi që universitetet para procesit zgjedhor nëpërmjet këshillave të etikës të verifikonin ligjshmërinë e fitimit të titujve akademikë për kandidatët, duke përfshirë edhe kontrollin anti- plagjiaturë.**⁶



⁵ <https://fau.edu.al/wp-content/uploads/2019/01/Vendim-777.pdf>

⁶ <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Urdher-nr-8-dt-14.1.2020-zgjedhje.pdf>

Ky akt nënligjor i delegimit të kopetencës për të kontrolluar palgjaiturën nga universiteti nuk bazohej në VKM nr. 777, e për rrjedhojë ishte i paligjshëm, prandaj Këshilli i Minsitrave për ta legjitimuar këtë akt ndryshoi VKM për kontrollin Anti – Plagjiaturë në datën 5 shkurt 2020, duke ia deleguar përgjegjësinë IAI-ve publike për të kryer kontrollin e plagjiaturave dhe verifikimin e titujve.



Ky veprim së pari kthehu në pikën 0 situatën dhe iniciativën e ndërmarrë në kuadër të paktit për universitetin, së dyti ekzistonte mundësia të shndërrohej një armë në duart e Këshillit të Etikës për të eliminuar kandidatët që mund të rivalizojnë rektorët dhe dekanët aktualë.

Ministria e Arsimit pasi hoqi dorë nga zotimi që u bëri studentëve për sa i përket kontrollit të titujve akademike në universitete filloi të promovojë Platëformën Akademia duke trajnuar universitetet se si ta përodrin për të kontrolluar disertacionet e kandidatëve për pozicionet drejtuese në zgjedhje dhe stafeve akademike.



Kontrolli Anti – Plagjiaturë në zgjedhjet e 30 korrikut në Universitete

Minsitria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë nën trysninë e pandemisë dhe studentëve u detyrua të shtyjë zgjedhjet në IAI-të publike për të dytën herë duke i caktuar në datën 30 korrik 2020. Pjesë e Urdhrit të Ministres ishte edhe zbatim i pikës 4 të Urdhërit nr.8 të janarit, ku thuhet shprehimisht se organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë duhet të realizojnë procesin e garantimit të integritetit akademik të të gjithë kandidatëve që do të marrin pjesë në zgjedhjet e 30 korrikut. **Kjo dispozitë nënkupton faktin se çdo kandidat duhet ti nënshtrohej kontrollit anti-plagjiaturë dhe verifikimit të titujve shkencorë dhe rezultatet të ishin pjesë e dosjes së tij të kandidimit.**

Universitetet publike të dakordësuara në heshtje për të mos e realizuar kontrollin anti-plagjiature sajuan një mjet të ri, të paparashikuar as në VKM nr. 777, as në Urdhrin e janarit 2020 të Ministres së Arsimit i cili u quajt “Formulari i Vetëdeklarimit Anti-Plagjiaturë”.

Universitetet publike parashikuan në unison në Rregulloret e tyre të zgjedhjeve se cdo kandidat për organet drejtuese duhet të ketë plotësuar **këtë formular, duke anashkaluar kontrollin anti-plagjiaturë** dhe verifikimin e titujve akademikë si hallka të rëndësishme për integritetin akademik të pedagogëve dhe drejtuesve. Ky tjetërsim i procesit të kontrollit prodhoi kandidatura jocilësore të cilat ishin akauzuar me fakte më herët për plagjiaturë në punimet e tyre dhe uli nivelin e konkurrencës pasi drejtuesit aktualë si kontrollues të Këshillave të Etikës u kthyen në kandidatë të pa konkurrueshëm.

FORMULAR VETËDEKLARIMI
NË ZBATIM TË RREGULLORES
“PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET
DREJTUESE DHE SENATIN AKADEMIK NË UNIVERSITETIN
ALEKSANDËR MOISIU”

Në mbështetje të Nenit 18/19/20/21 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin Aleksandër Moisiu”, unë....., kandidat për postin..... deklaroj nën përgjegjësinë time për mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e Gradës/Titullit shkencor.

Emër Mbiemër

Për t'u siguruar lidhur me ecurinë e kontrollit Anti-Plagjiaturë në universitete Qëndresa Qytetare iu drejtuar Rrjetit Akadmiq Shqiptar me një kërkesë për informacion duke kërkuar bilancin e kontrollit për periudhën Mars – Shtator 2020.

Nga përgjigja e kthyer rezulton se **vetëm 4 nga 12 universitete e kanë shfrytëzuar platformën** Akademia.al ndërsa 8 universitetet e tjera, përfshi edhe universitetin e Tiranës nuk e kanë shfrytëzuar platofrmën anti-plagjiaturë.

#	Emri i Universitetit	Përshkrimi	Fjalët të alokuara	Fjalët të shfrytëzuara	Fjalët të pashfrytëzuara	Nr i fjalëve për alokim	Nr i dorëzimeve
1	Universiteti i Tiranës	Universiteti i Tiranës	3,430,008	0	3,430,008	3,430,348	0
2	UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS	UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS	422,613	585,341	37,272	0	42
3	UNIVERSITETI I SPORTEVE I TIRANËS	UNIVERSITETI I SPORTEVE I TIRANËS	72,047	0	72,047	72,037	0
4	UNIVERSITETI "EQEREM CABELI" GJIROKASTËR	UNIVERSITETI "EQEREM CABELI" GJIROKASTËR	72,047	0	72,047	72,017	0
5	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	331,416	0	331,416	331,346	0
6	UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË	UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË	90,059	0	90,059	90,059	0
7	UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE	UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE	373,128	0	373,128	373,098	0
8	UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS	UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS	1,120,711	654,724	465,987	0	57
9	UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI" SHKODËR	UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI" SHKODËR	216,141	0	216,141	216,081	0
10	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	710,902	421,977	297,925	0	14
11	UNIVERSITETI I ARTEVE I TIRANËS	UNIVERSITETI I ARTEVE I TIRANËS	46,831	19,797	27,034	6,811	3
12	UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN	UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN	309,802	0	309,802	309,752	0



Këshillat e Etikës

Këshillat e Etikës janë organet e universiteteve publike që duhet të realizojnë kontrollin anti- plagjiaturë dhe duhet të marrin masa administrative ndaj pedagogëve në artikujt e të cilëve evidentohen plagjiatura. Nga një monitorim i kryer mbi faqet zyrtare të internetit të **7 universiteteve kryesore publike në vend, vetëm 3 prej tyre kanë bërë publike përbërjen e Këshillit të Etikës dhe asnjë universitet nuk ka publikuar një vendim të këtij organi.**

Pas thellimit në këtë monitorim u vu re se në dy prej 7 universiteteve, anëtarët e Këshillit të Etikës ishin në konflikt interesi pasi mbanin edhe pozicione të tjera drejtuese akademike në universitet duke pamundësuar një gjykim të drejtë dhe të paanshëm për kandidatët në zgjedhjet e 30 korrikut, disertacionet e tyre dhe të personalit akademik në varësi. Kjo lloj përbërje e Këshillave të Etikës, si organe gjykuese për integritetin akademik në universitete nuk siguron transparencë, paanshmëri dhe demokraci në vendimarrjen e tyre.

Universiteti	Këshilli i Etikës Publik	Vendimet e K. të Etikës publike	Konflikt interesi në përbërjen e Këshillit të Etikës
Uni. i Tiranës	PO	JO	JO TRANSPARENT
Uni. "Aleksandër Moisiu"	JO	JO	JO TRANSPARENT
Uni. "Aleksandër Xhuvani	PO	JO	PO
Uni. Bujqësor i Tiranës	JO	JO	JO TRANSPARENT
Uni. i Korçës	PO	JO	PO
Uni. "Luigj Gurakuqi"	JO	JO	JO TRANSPARENT
Uni. Politeknik i Tiranës	JO	JO	JO TRANSPARENT



Rekomandime



Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, **duhet të krijojë menjëherë Arkivin Digjital të disertacioneve** të përdorura për fitimin e gradave dhe titujve shkencore, bazuar në VKM nr. 777.



Anëtarët e Këshillave të Etikës në universitetet publike duhet të **mos kenë konflikt** *interesi* gjatë ushtrimit të detyrës së tyre.



Proçesi i vetingut akademik ne dobi te ngritjes se cilësisë së arsimit dhe në respekt të kërkesave të studentëve duhet të realizohet për të gjithë pedagogët dhe drejtuesit e institucioneve nëpërmjet kontrollit Anti – Plagjiaturë dhe verifikimit të titujve akademik nga Këshillat e Etikës në Universitete.



Këshillat e Etikës duhet t'i referojnë në prokurori të gjitha rastet e evidentuara për plagjiaturë sipas nenit 148 të kodit penal që kanë vetedeklaruar mungesën e plagjiaturës në punimet e tyre shkencore.



Universitetet publike duhet të bëjnë transparencë lidhur me procesin e vetingut akademik, të **publikojnë vendimet e Këshillave të Etikës në faqen zyrtare** të internetit dhe të marrin masa për pedagogët jomeritorë.



#QËNDRESË MIRËQEVERISJE